



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME**  
**Nr.01-060/01-9920/23 datë:19.04.2023**



Npi – 01/156 datë: 27.04.2023

Duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008); Rregulloren e (MAPL) Nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës; Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 datë 03.09.2008; Si dhe Vendimin e Kryetarit të Komunës Nr.02/296 i datës 27.02.2023, për themelimin e grupit punues për hartimin e Draft-Planit Komunal për Integritet 2023-2027, Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më 27.04.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMUNAL PËR INTEGRITET 2023-2027**

**I**

**Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -IV- të rregullt për vitin 2023, e mbajtur më: 27.04.2023, unanimisht miratoi Planin e Komunës së Shtimes për Integritet 2023-2027.**

**II**

**A r s y e t i m:** Plani Komunal për Integritet 2023-2027, është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për politikë dhe Financa, si dhe procesin e diskutimit publik me qytetarë. Në mbështetje të agjendës evropiane dhe kërkesave që dalin si kritere obliguese për përmbushje nga komunat, Kryetari i Komunës me vendimin Nr.02/296 datë 27.02.2023 ka themeluar grupin punues për hartimin e Draft-planit komunal për Integritet 2023-2027. Plani për Integritet është dokument strategjik dhe operativ i Komunës, që bazohet në rezultatet e procesit të vlerësimit të rrezikut për integritet për të gjitha proceset e punës në institucionet komunale.

**III**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

**IV**

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi